ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE & KULTURORE

Themelues **BUJAR HUDHRI**
Kryeredaktore **VIOLETA MURATI**

E PREMTE, 16 NËNTOR 2018. NUMRI 1. VITI I I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

SOT NË PANAIR

LIBRI I FUNDIT I KADARESË

NJË LIBËR PËR MARRËDHËNIET E NDËRLIKUARA TË SHKRIMTARIT ME EPOKËN E VET

ZANAFILLA E LIBRIT "KUR SUNDUESIT GRINDEN"

Nga BUJAR HUDHRI *(fq. 2)*

NË BRENDËSI NJË FRAGMENT I SPROVËS "KUR SUNDUESIT GRINDEN"

EDITORIAL

Për një mirëkuptim midis shkrimtarit dhe lexuesit

Nuk ka dyshim se një nga humbësit më të mëdhenj që nga rënia e komunizmit, është shkrimtari shqiptar. *(Vijon në fq. 2)*

PRISHTINA E MEHMET KRAJËS
(fq. 6)

RIDVAN DIBRA, PROVOKON ME ROMANIN E RI
(fq. 7)

MIRA MEKSI ME "HAKMARRJA E KAZANOVËS"
(fq. 10)

VIRION GRAÇI: KAM DËSHMUAR PËRJETIMET E MIA
(fq. 11)

AGRON TUFA RIBOTON "FABULA RASA"
(fq. 14)



AZEM DELIU: SHËNIMET E KRIMBIT SMOLINSKI
(fq. 15)



Ribotohet "SKËNDERBEU Një histori politike" e prof. Aurel Plasarit vlerësuar me Çmimin Shkencor Ndërkombëtar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë *(fq. 12)*

Pas 70 vjetësh kthehen në atdhe eshtrat e Mid'hat Frashërit, figurë e shquar e kulturës dhe shkencës shqiptare.

Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo" boton vellimin e tretë të veprës së plotë të tij *(fq. 9)*

Ferid Hudhri

sjell një enciklopedi të kujtesës figurative për historinë, kulturën dhe trashëgiminë kombëtare *(fq. 13)*



PËR NJË MIRËKUPTIM MIDIS SHKRIMTARIT DHE LEXUESIT

(*Vijon nga fq. 1*)

Kjo mund të tingëllojë paradoksale, por historia e këtyre tri dekadave e ka dëshmuar tashmë. Gjithmonë flasim për mijëra e mijëra shqiptarë që morën rrugët e botës duke shkuar si klandestinë. Por, a e marrim me mend se libri ishte i pari që u hoq nga bagazhi i tyre? Sa mijëra lexues të tyre kanë humbur shkrimtarët shqiptarë? Si do të ishte pozita e shkrimtarit shqiptar, pa këtë zhvendosje të popullsisë jashtë vendit? Apo nga zonat rurale drejt qyteteve të mëdha? Sepse, vetëkuptohet, në të gjitha këto lëvizje që sjellin ndryshime dramatike në jetët në vazhdim, libri zor se mund të zërë vendin që i takon. Edhe në qoftë se sistemohen në punë apo gjejnë një strehë. Kjo e vështirësoi komunikimin e shkrimtarit, gati e bëri të pamundur. Por nuk është vetëm kjo.

Një ndërlikim tjetër për shkrimtarët shqiptarë ishte futja e letërsisë së huaj të ndaluar nga regjimi i dikurshëm. Edhe ajo ashtu erdhi: klandestine, përkthyer me nxitim për të shuar etjen e lexuesit shqiptar. Shumë botues kanë bërë një punë të lavdërueshme, duke sjellë shqip ato libra që pa të drejtë u ishin mohuar në vite lexuesit. Por, me dhimbje, duhet ta pranojmë që kjo e largoi lexuesin nga letërsia shqipe që botohej jo vetëm në Shqipëri, por kudo ku ajo krijohej në Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi etj. Janë fare pak botues që e kanë mbështetur shkrimtarin shqiptar në këto vite. Por vetmia e librit shqip vazhdon ende dhe vendi i shkrimtarit shqiptar nuk është aty ku kultura jonë do të ndjehej e plotësuar.

Gazeta e re "ExLibris", vjen me një synim të qartë: të nxisë dhe të mbështesë mirëkuptimin midis shkrimtarit shqiptar dhe lexuesit të tij. Të bindur se kjo mund të arrihet vetëm me bashkëpunimin mes shkrimtarëve, kritikëve, studiuesve, përkthyesve dhe botuesve, kjo gazetë do të jetë e hapur për cilindo që ia do të mirën këtij vendi dhe kulturës së tij në këto kohëra të vështira për librin.

ZANAFILLA E LIBRIT TË RI TË KADARESË

Nga BUJAR HUDHRI

"Te porta e konviktit të institutit, pashë Jevtushenkon.

- E ke parë gjë Bellën? - më pyeti."

Ky dialog nga romani "Muzgu" i Kadaresë, m'u kujtua kur në daljen kryesore të aeroportit Sheremetevo, në Moskë, u shfaq vërtet poeti i shquar rus, Evgenij Jevtushenko. Sapo kishte zbritur nga avioni, me një çantë në krahë, duke tërhequr valixhen dhe me siguri po kërkonte taksi. Më shkrepi në kokë ta pyesja "E ke parë gjë Kadarenë? Mos ishit në një avion?" M'u desh pak kohë të mbledh pak veten e t'i formuloja në rusisht pyetjet, kur shoh përballë të vinte Kadareja dhe nxitimin e operatorit për të fiksuar mbërritjen pas gjysmëshekulli të tij në Moskë. Nga neonet fytyra e tij dukej edhe më e lodhur dhe ngulmimit tim që ai të takohej me Jevtushenkon iu përgjigj me indiferencë. Si shumë po i jepja rëndësi. Dhe kjo situatë u zgjidh kur vura re që poeti rus hapi derën e pasme të taksisë dhe u nis menjëherë. Hipëm edhe ne në një makinë fuoristradë, që e drejtonte një mik i ambasadës sonë. Erdhi dhe operatori për të fiksuar që nga brenda këtë udhëtim. Ishte e gjatë rruga deri te hoteli, i cili ndodhej mbi një orë nga qendra. Ecëm pothuaj pa folur. Një grup televizioni nga Tirana kishte ardhur për të xhiruar Kadarenë për filmin që fliste për jetën e tij. Isha bashkuar edhe unë grupit me kërkesën e vetë Kadaresë. Në një nga paraditet tona te bar "Juvenilja" në Tiranë i kisha sugjeruar se duhej patjetër të xhironin edhe në Moskë, si një stacion i rëndësishëm i jetës dhe krijimtarisë së tij. Dhe ja, pas një muaji, në qershor 2010, udhëtoj përmes Moskës me Kadarenë e tanishëm, por edhe me Kadarenë 22 vjeçar të "Muzgut". Aq herë e kisha lexuar këtë roman, sa më dukej se i njihja rrugët, bulevardet, stacionet e trenit, metrotë, monumentet. Gjithë personazhet, dialogjet e tyre. Në këtë qytet të pafund ku shkelja për herë të parë, më dukej sikur të vetmet kujtime që më lidhnin me të, ishin faqet e këtij romani.

Ishte kjo arsyeja, me siguri që kisha ngulmuar

Në parkun Gorki, Moskë, qershor, 2010.

Përpara konviktit të Institutit Gorki, Moskë, qershor, 2010.

për të ardhur gjer këtu. Të nesërmen në mëngjes shkuam në Institutin Gorki, pamjet e të cilit janë fiksuar në filmin e regjisorit Milkani. Por në mendje më ka ngelur dita e fundit, mbresa të cilat asnjë kamera nuk i kapi. Por as që mund t'i kapte dot. Kisha këmbëngulur për të shkuar në vilën e Pasternakut, në Peredelkino. Duhej të kujtohej Kadareja, mbase, por ai gjatë gjithë kohës së xhirimit ka qenë krejt indiferent, thua se filmi bëhej për një shkrimtar tjetër. Ndërsa grupi i xhirimit, as që e kishte parashikuar këtë ndalesë në film. M'u kujtuan këto në makinën e ambasadorit i cili ishte shumë i gëzuar që po shkonim në Peredelkino. Për këtë shkak, më erdhi keq t'i tregoja për emailin që më kishte dërguar një nga vartësit e tij, kur u interesova për vilën e Pasternakut. Po përse do të shkojë Kadareja në Peredelkino? Apo të kërkojë eshtrat e Pasternakut? më shkruante diplomati ynë. Dhe të mendosh që kishte kryer studimet në Institutin Gorki!

Pas pak doli përpara nesh vila e Pasternakut. E kisha parë me dhjetra herë në foto, filma, video. Në të gjitha stinët. Tani ishte qershor, gjelbërimi dhe lulet kishin mbuluar gjithçka. I pari që u afrua te dera e vilës ishte Kadareja, i cili gjithë rrugën nuk kishte folur një fjalë, befas u gjallërua menjëherë. Dhe filloi të fliste rusisht me zonjën që po na priste. Kadareja po i thoshte se ishte njohur dhe kishte takuar në Paris disa herë, Ira Emeljanovën. E ndjeva menjëherë që diçka ngeci. Kadare nuk e dinte se zonja, e cila ishte drejtorja e shtëpisë muze, ishte nusja e djalit të Pasternakut, me gruan e parë. Ndërsa Ira Emeljanova ishte vajza e të dashurës së Pasternakut. Dëgjova që ajo i foli pa takt, pothuaj me zemërim. *Ona sumashedshçaja* [ajo është e lojtur]. Ajo nuk pranohet këtu. Me siguri, Kadare u skandalizua nga kjo sjellje. I ktheu shpinën dhe hyri brenda. S'kishte nga ta dinte Kadare ç'ishte kjo sjellje e çuditshme. Për mua ishte fare e qartë, e kisha ndeshur disa herë në Tiranë. Shpesh, mes botuesve dhe trashëgimtarëve të shkrimtarëve dhe përkthyesve që s'jetonin më. Edhe Pasternaku ende nuk e ka të botuar veprën e plotë. Me siguri, mosmarrëveshjet mes njerëzve të afërm për çështje pronësie apo mërira.

Hipëm lart. Ishte dhoma e gjumit. Shumë qetësi. Pranë derës të varur në mur ishte kapelja, palltoja dhe çizmet. Ishin vënë në një vijë dhe të dukej se Pasternaku qëndronte në këmbë e na kishte kthyer shpinën. Sikur ishim futur në zonën e vdekjes. Kthehem nga Kadareja dhe shoh se fytyra i kishte marrë një ngjyrë purpuri. Zbritëm në heshtje shkallët dhe u gjendëm në katin e parë, te dhoma ku kishte dhënë shpirt Pasternaku. Këtu ishte shtrirë dhe nuk ishte ngjitur më në dhomën e tij të gjumit. Mbi shtrat çdo ditë ndërrohej një buqetë me lule të freskëta. Në mur ishin dy piktura të babait të tij, Leonid Pasternak, mik i Tolstoit.

Kur dolëm jashtë, zonja gjeti rastin të afrohej me Kadarenë dhe na ftoi të shkojmë te varri i Pasternakut. U nisëm të gjithë, si një kortezh. Askush nuk fliste. Pas nja dyqind metrash, u dukën gurët e varreve. Përballë varrezave ishte selia verore e Patriarkut të Rusisë. Te guri i varrit të Pasternakut ishte gdhendur një basoreliev. U ulëm të gjithë në një stol druri. Heshtjen e prishi vetëm zonja, e cila, si për të kërkuar ndjesë pë sjelljen e saj, na tregoi diçka që nuk ia thoshte çdokujt. Njëherë, kur kishin ndërruar traun e kalbur të stolit ku ishim ulur, kishin gjetur përgjues të futur në brendësi. Të mos ishte thyer trari as që do të kuptohej se çfarë kishte bërë KGB!

U kthyem vonë në hotel. Kadare shkoi në dhomë, ndërsa unë ndenja në holl. Nuk kaloi gjysmë ore, kur e shoh të vinte drejt meje. Nuk e kishte zënë gjumi i pasdites. Ndoshta nga e gjithë ç'kishte parë dhe dëgjuar në Peredelkino. U ul në tavolinë me mua në barin e vetëm që ishte në një kënd të hollit. Pastaj te recepsioni më zunë sytë një grua e cila i ngjante krejt Helena Kadaresë. Po bisedonte me recepsionisten dhe nuk ia shihnim fytyrën. Si Euridicja me Orfeun, i thashë, me shaka. Mos e kthe kokën. Ndërsa ai, befas, u kujtua që televizori në dhomë nuk i ndizej dhe m'u lut nëse mund të bëja diçka. Pa e zgjatur morëm ashensorin dhe u ngjitëm lart. Sa hyra në dhomë më ra në sy menjëherë që kablli i antenës kishte rënë në dysheme. E mora dhe e vendosa në vendin e vet. Kur drita e ekranit u derdh mbi fytyrat tona, na tërhoqi menjëherë pamjet e një filmi bardh e zi. Në plan të parë portreti i Pasternakut. Pastaj i Anna Ahmatovës. Pas disa sekuencash, i të dyve bashkë. Ishte një film dokumentar për jetën e Pasternakut. Dukej kaq e pabesueshme. E gjitha kjo, në fund të një dite që ia kishim kushtuar vetëm Pasternakut. Sikur të ishte një skenar dhe ne po i bindeshim pikë për pikë. Ndenjëm të shtangur, pa folur gjysmë fjale, deri sa përfundoi filmi.

Më pas, shumë herë e kam biseduar me Kadarenë atë moment magjik. Për t'i mbushur mendjen vetes, se e gjitha kjo ishte një ëndërr, mbase? Po si ndodhi? Po si koincidoi? Si u gjendëm pikërisht në atë çast ndërsa jepej ky filmi nga kanali i njohur rus "Kultura"? S'ka përgjigje. S'mund të ketë, ndoshta. Fati ma kishte sjellë të isha në një zonë midisëse. Ku plekseshin kohërat, vendet, ngjarjet, personazhet. Ndaj kur Kadare më dorëzoi faqet e para të librit të ri, tre vjet më parë, m'u duk sikur isha ende atje, në atë dhomë të atij hoteli të stërmadh, me një emër të denjë për të, "Kozmos". Dhe gjëja e parë që më shkoi ndërmend ishte se po e gjeja zanafillën e këtij libri. Kisha qenë me autorin pikërisht në ato vende që lexova në dorëshkrim dhe kjo më dukej kaq e natyrshme ta mendoja kështu. Por çdo ditë që kalonte, aq më shumë më largohej ky mendim. Ky libër mbase e ka zanafillën tek romani "Muzgu", apo te poemat për Llorën, për.... Apo qysh në momentin kur redaktori i librit të tij të parë i thotë, po si nuk ke një vjershë për Moskën? Edhe më herët akoma, ndoshta. Që në lindjen e shkrimtarit. Sepse Pasternaku këtu është sivëllai i tij, Kadare. Me një fat më të bukur, natyrisht. Për fatin e ne të gjithëve. Për të gjitha gjuhët e botës.

Ky libër mbase e ka zanafillën tek romani "Muzgu", apo te poemat për Llorën, për.... Apo qysh në momentin kur redaktori i librit të tij të parë i thotë, po si nuk ke një vjershë për Moskën? Edhe më herët akoma, ndoshta. Që në lindjen e shkrimtarit. Sepse Pasternaku këtu është sivëllai i tij, Kadare. Me një fat më të bukur, natyrisht. Për fatin e ne të gjithëve. Për të gjitha gjuhët e botës.

KUR SUNDUESIT GRINDEN

PJESË NGA KAPITULLI
I PARË I SPROVËS



Stacioni ndodhet në trotuarin e djathtë. Numri i trolejbusit është tre. Do të vazhdosh rrugën gjer në Sheshin Pushkin. Atje është shtatorja që ti, me siguri, e di. Exegi monumentum etj. Pastaj ec në të djathtë të saj, kapërce Rrugën Gorki dhe pak hapa më tej nis Tverskoj Bulvar, që kryqëzohet me të.

Më tej gjithçka është e thjeshtë. Më pak se një minutë ecje me këmbë, në trotuarin e djathtë të tij, porta e Institutit Gorki të del përpara. Të del vetë, më kupton? Edhe të mos duash, të del përpara… Si të mos dua? Ka vite që ëndërroj të vij këtu. Përse të mos dua? Përse? Ajo s'dihet. Sa herë kujtojmë se duam një gjë e, në të vërtetë, s'e duam.

O, jo. Jam munduar kaq shumë sa të arrij gjer këtu. Trolejbusët hungëronin si kuaj të egër. Kishte gropa kudo. Gjersa sytë më kapnin, më në fund, shtatoren e famshme. Ecja, siç më kishin thënë, në të djathtë të saj…

Ç'shtatore, djalosh? Je duke folur përçart. Nuk ka shtatore të tillë këtu… Si s'ka? Shtatorja e Pushkinit. Kam shëtitur kaq herë përbri saj. Të kanë bërë sytë, s'ka pasur kurrë të tillë. Ha, ha, po atë e di gjithë bota: exegi monumentum… ti vetë e the. Një monument unë ngrita… Vazhdo, djalosh. Një monument unë ngrita, që duart dot s'e ngrenë. E pra, një monument "njerukotvornyj". Re vetë në grackë. Një monument ngritur jo duarsh, por shpirtrash, thotë poeti. Pra, një shtatore që kurrkush s'e sheh, veç budallenjve. Ashtu si ju, studentët e Institutit Gorki.

Ne s'ishim ashtu. Ju ishit më keq. Secili ëndërronte ta shembte shtatoren e tjetrit, për të ngritur të vetën. Në mitingun e Pasternakut? Kurrsesi, s'ishte ashtu. Ishte tjetër gjë. Ke qenë në atë miting? Ke ulëritur kundër tij? Asnjëherë. Ç'bëje, ndërkaq, kur të tjerët ulërinin? Vështroja një vajzë të përlotur. Kujtoja se ishte mbesa e tij.

Ti vjen pas kaq vitesh për ta parë përsëri? Të duket se mitingu vazhdon? Ndoshta. Në të vërtetë, ka gjasë që vazhdon. Nga britmat e largëta, më saktë se nga tabela e portës, mund ta gjesh vendin e grumbullimit. Në Moskë a në Tiranë është e njëjta zhurmë që s'resht.

Ankthi i mësipërm është përsëritur me vite, në format më të pabesueshme. Rënkimi i trolejbusëve sipër pengesave dhe gropave të rrugës. Monumenti i kërcënuar. Dhe lotët dhe Moska e ëmbël.

Isha aq i bindur se do të shkruaja për të, saqë kishte çaste kur më dukej se kjo ishte bërë ndërkaq, madje sasia e shkronjave që do të më duheshin për të krijuar fjalët, ishte stivuar në këndin e vet, në pritje.

Shpeshtimi i udhëtimeve të ëndërrta ishte shenja më e sigurt se koha po afronte. Turbullimi dhe mungesa e logjikës në to sa vente e shtohej. Trolejbusi numër tre, qëllonte që nuk bindej për t'u nisur. Detyroheshin ta rrihnin me fshikull. Që kur kështu? thosha me vete. Kisha disa vjet që isha larguar nga Moska dhe ishte e kuptueshme se shumë gjëra kishin ndryshuar, megjithatë, që të shkonte puna gjer te rrahja me kamxhik e trolejbusit, s'do ta kisha besuar kurrë.

Në Tiranë vazhdonte fushata për njohjen e jetës. Shkrimtarët, pothuajse pa përjashtim, e kishin pranuar se kishin mangësi, sidomos për njohjen e punëtorëve të uzinave, pa folur pastaj për kooperativat bujqësore. Pa i thënë askujt, e kisha nisur ndërkaq romanin për Moskën, por s'isha fare i sigurt se do ta vazhdoja. Ditën më dukej fare i pamundur, ashtu si vetë Moska, që ishte bërë e tillë për të gjithë. Me prerjen e marrëdhënieve diplomatike, kishte humbur çdo shpresë e fundit për ndonjë udhëtim atje. Kurse natën, sidomos pas mesnatës, gjërat ndryshonin. Bija në gjumë me shpresën se do të më shfaqej pikërisht midis tij. Kjo ndodhte përherë e më rrallë. E si të mos mjaftonte kjo, kaosi i saj vazhdonte të dëndësohej, aq sa nuk e gjeja dot as vetë nëse ai kaos më pengonte apo më hynte në punë për atë që kisha ndër mend.

Ishte kjo e dyta, me sa dukej, që po ndodhte. Ndryshe nga uzinat dhe kooperativat, Moska e romanit tim kishte nevojë për të kundërtën, mosnjohjen.

Në një nga ëndrrat, pasi e kalova gati duke

u zvarritur Sheshin Pushkin, i gjeta shumicën e studentëve në miting. Pothuajse e dija, megjithatë s'mund të them se nuk u befasova kur pashë në pankarta emrin tim. E fill pas kësaj, nisa të dëgjoj përherë e më qartë klithmat kundër meje.

Midis tyre ishin disa nga shokët e kursit. Petros Anteos s'dinte ku t'i çonte sytë, kurse letonezi Stulpanz, miku im më i ngushtë, kishte zënë kryet me duar.

Të ka telefonuar shefi i madh atje në Tiranë, thirri një bjellorus i zemëruar. Ai, Stalini juaj, që s'më kujtohet emri.

Bëra "po" me krye, por ai nuk u zbut.

Sa versione ka për telefonimin e tij?

Në të vërtetë s'më kujtohej, megjithatë desha t'i them se mund të ishin tri ose katër, jo më shumë, por nuk arrita, ngaqë u zgjova.

Telefonimi i Enver Hoxhës kishte ndodhur vërtet përpara ca kohe. Ishte mesditë, ndodhesha si zakonisht në Lidhjen e Shkrimtarëve kur zëvendës-kryeredaktori i gazetës "Drita", duke më zgjatur telefonin, më tha se dikush më kërkonte.

Jam Haxhi Kroi, tha zëri. Me ju do të flasë shoku Enver.

Nuk arrita të them asgjë, veç fjalës "falemnderit"! Më përgëzoi për një poemë që sapo ishte botuar në gazetë. Unë thashë prapë "falemnderit". Ai tha se i kishte pëlqyer shumë dhe, ndërsa iu bëra një shenjë të tjerëve që të mos bënin zhurmë, pa qenë në gjendje të shqiptoja diçka tjetër, përsërita një "falemnderit" të tretë.

Ç'janë këto katër falënderime rresht, tha njëri nga redaktorët. Kur na qenke bërë kaq i sjellshëm?

S'dija si t'i paralajmëroja, veç bëra një shenjë tjetër me dorë, që vështirë se mund të kuptohej ç'donte të thoshte.

Ishte Enver Hoxha. Ishin të vetmet fjalë që arrita të them, kur telefoni u mbyll.

Vërtet? Si? Ai vetë?

Po, u përgjigja.

Po si? Ç'të tha? Po ti? Si nuk i the asgjë?

U përgjigja: nuk e di. Siç duket, u hutova.

Iu tregova për përgëzimin e tij dhe ata prapë shfaqën keqardhjen që nuk fola pak më tepër, veç njërit, që më dha të drejtë, duke sqaruar se, në raste të tilla të lidhej goja…

Idiot, i thashë me vete bjellorusit të ëndrrës.

Në ditët e fushatës kundër Pasternakut, telefonimi i tij me Stalinin, lidhur me Mandelshtamin e arrestuar, përmendej si një nga ngjarjet kryesore për ta poshtëruar poetin. Sidomos ajo pjesë e bisedës kur Stalini e pyeste ç'mendonte për Mandelshtamin. Tregoheshin pesë apo gjashtë versione të saj, por flitej se kishte shumë më tepër, njëri më i keq se tjetri.

Idiot, e shava prapë bjellorusin, po më shumë veten time, që shikoja ëndrra të tilla.

Kjo s'më pengoi që një copë herë ta vrisja mendjen nëse mund të kishte ose jo tjetër version.

Shoku Enver do të flasë me ju… Ç'mendoni për Mandelshtamin… Domethënë për Lasgush Poradecin, ose për Paskon ose Markon që … burg … domethënë që ndonëse sapo kishin dalë nga burgu…mund të ktheheshin prapë atje… Ose më thjesht, për Agollin, Qiriazin, Arapin… që… burg… domethënë që ndonëse ende burg s'kishin bërë. Që t'i biem shkurt, ç'mendon për veten tënde.

Për këtë të fundit, domethënë veten time, mund ta kisha më lehtë. Unë, si të gjithë, mendoj të shkruaj për jetën… Pavarësisht nga një novelë e pabotuar, që mund të jetë bërë problem gjer te shoqja N., për jetën studenteske në Moskë. Ndonëse ngjarjet ndodhnin larg, në breg të Baltikut, në vendin e quajtur Dubulti, në një shtëpi pushimi shkrimtarësh.

Ç'mendim keni për Pasternakun?

Pyetja ngjante e befasishme, ndonëse nuk ishte aspak e tillë. Në të vërtet ishte e vetmja që nuk do të doja të më bëhej.

Pasternaku? S'kisha të bëja me të. Veç një ditë e kisha parë nga larg në Peredjelkino. Edhe në qoftë se përmendej në vazhdimin e novelës, kjo lidhej me fushatën, në sfond të së cilës ndodhnin ngjarjet. Ishte një e afërme e tij në Institutin Gorki. Një studente e vitit të dytë, që i kishte sytë vazhdimisht me lot. Për arsye që merreshin me mend.

Isha gati të zgjatesha në hollësira të kota, veç të mos vinte pyetja tjetër, që po më dukej edhe më e keqe, ajo e çmimit Nobel.

Ishte e lehtë të thoshe se shumica e studentëve, ndërsa ulërinin në kor kundër tij, nuk ëndërronin veç për të. Ndërkohë s'ishte fjala për ta, por për mua vetë. Mos do të thosha se s'më kishte shkuar as në mendje? Natyrisht që jo. Mendja më kishte shkuar shpesh, sidomos më pas, shumë kohë më pas, kur u pëshpërit se mund të isha unë vetë… në atë listën.

Aha, ndaj edhe zhurma kundër Pasternakut është përshkruar aq habitshëm, gjithsesi pangjashëm. Thua se s'është vetëm për të, por veç tij, edhe për dikë tjetër. Ndoshta për ty vetë. Ndaj nervozizmi ishte i keq e njëherazi dehës. Ti, i vetëm, përballë vendit tënd, që të shan e të ulërin mu në fytyrë, me urrejtje dhe dashuri të bërë njësh. Ktheje atë çmim të nëmur, klithnin të gjithë studentët, gratë shtatzëna, minatorët e Tepelenës. Ndërsa ti, trillan që lëkundesh, ta marr a mos e marr, si të thuash, mëdyshje Hamleti. Dhe patriarku Sterjo Spasse, që ashtu si Kornei Çukovski, që i shkoi në daçë Pasternakut, të vinte tek ty, të kam si djalin tim, sot jam, nesër s'jam, për hir të kujtimeve të Moskës… ktheje atë helm sa s'është vonë!

Për fat të mirë, gjendje të tilla më ndodhnin rrallë. Ato që në mendjen time i quaja shtegtime moskovite të natës, rralloheshin sa herë që mbaja shënime për romanin. Ishte i vetmi që po më zgjatej mbi dhjetë vjet. Shkruaja herë pas here disa faqe, thua se përpiqesha ta merrja me të mirë. Së paku t'i tregoja se nuk po e braktisja.

Ishte si të mbaje një shpend të bukur, por tepër të rrezikshëm, në kafaz. Kishte çaste që nervozohesha kundër tij dhe natyrisht kundër vetes. Thelbi i acarimit lidhej me detyrimin që ata (domethënë romani, unë vetë, ca flokë vajzash, Moska, arti) kujtonin se kisha ndaj, Zoti e dinte kujt, për ta kryer atë… rit.

Në çaste të tjera, kur e mendoja punën qetësisht, gjithçka më dukej më e natyrshme. S'kishte pse ta dramatizoja, as t'i ankohesha kujt. Dhe aq më pak ta quaja detyrim, ose… rit. Kishte qenë e njëjta joshje e përhershme, ajo që disa e quanin dhunti e të tjerët marrëzi apo demon, që më shtynte. Ajo më ndante botën në dy pjesë: atë të përshtatshmen për librin dhe tjetrën, të papërshtatshmen. Kjo e dyta, në krahasim me të parën, ishte e pafundme. Kurse e përshtatshmja ishte tepër e rrallë. Dhe shenjat që jepte, ashtu ishin, të mjegullta, enigmatike, gjersa ti i kapje një ditë, pa i zbërthyer dot as vetë gjer në fund.

Kishte gjasë që Moska kishte hyrë befas në pjesën e përshtatshme të botës, ditën që ishte bërë e pamundur. Kishin mbetur vetëm ankthet e natës që mund të zëvendësonin avionët dhe vizat dhe aeroportet e paqenë. Dhe përveç tyre, mjeti më i sigurt, ai që mund të çante aty ku, siç e kisha thënë diku, as tanku më i tmerrshëm s'çante dot: romani.

Që Moska ishte bërë e pashmangshme, pikërisht në kohën që ishte kthyer në armiken numër një të Tiranës, kjo s'përbënte ndonjë habi. Befasimi mund të shkaktohej prej Pasternakut. Ç'donte ai në qytetin që porsa kishte hyrë në mbretërinë time? Midis flokëve të vajzave dhe letrave ku ende shkruhej, "ti the se do të vish prapë".

Shkurt, a mund të shkruaja për to pa Pasternakun? Secili në punë të vet. Ai me hallet e tij të rënda, unë me ku rrafsha mos u vrafsha-t e mia studenteske?

Sa më shumë që përpiqesha t'i mbushja mendjen vetes se s'ishte e vështirë, aq më tepër më ngjante ashtu. Gjersa e kuptova se ishte e pamundur. Ai kishte qenë atje… kur ndodhte gjithçka… Më saktë, unë kisha ndodhur… atje. Dhe s'mund të thosha se s'kisha punë me të. Ne të gjithë kishim pasur punë me të. Dhe do të kishim gjithmonë ngaqë ishim i njëjti fis, ai i shkrimtarëve.

Çështja e fisit kishte qenë një nga enigmat që s'i kuptoja dot në fëmini. Pyetjes sime këmbëngulëse se përse disa njerëz i kishim kushërinj e disa jo, gjyshja, pasi i qe shmangur disa herë përgjigjes, kishte thënë se këtë e caktonte Zoti, por unë s'duhej t'ia thosha askujt.

Pasternaku pranë fotos së Stalinit në Kongresin e Parë të shkrimtarëve sovjetikë, Moskë 1934.

"PRISHTINA" E MEHMET KRAJËS

Është një rrëfim tronditës për qytetin e palumtur dhe njerëzit e tij, të cilët për një aq të gjatë e pritën lirinë. Roman i nxehtë dhe i drejtpërdrejtë, i veçantë në letrat shqipe, që ndoshta nuk i bashkon të gjithë lexuesit, por me siguri i vë në mendime të gjithë. Narratori dhe protagonisti identifikojnë njëri-tjetrin, fate njerëzish pleksen në një botë midis reales dhe fiksionit. Duke qenë romancier me përvojë, Mehmet Kraja i zotëron të gjitha teknikat bashkëkohore shkrimore, prandaj vjen aq e fuqishme tabloja që krijon. I freskët dhe krijues, me një gjuhë që shpesh i kalon kufijtë e shprehjes, përveçse në përshkrime, kësaj radhe bëhet depërtues edhe në meditim.



Pse një libër për Prishtinën?

Një libër për Prishtinën ka shumë arsye: letrare, kulturore, politike, historike. Dhe më shumë se kaq: një frymëzim nga një jetë që ka ngritje dhe rënie, përplasje nga më të çuditshmet, por, mbi të gjitha, ka shumë dhembje. Aty ku ka dhembje, ka edhe shumë arsye për të bërë letërsi. Në fillim të këtij shekulli Prishtina u bë qytet-metaforë. Ajo vazhdon të mbetet e tillë: tokë e premtuar, ëndërr dhe zhgënjim njëkohësisht. Është vend ku njerëzit luftojnë njëkohësisht për mbijetesë dhe lavdi heronjsh.

Ju botoni në Tiranë librin për Prishtinën, pse e keni shmangur qytetin tuaj?

Unë nuk njoh kufizime të këtilla, prandaj nuk më bën përshtypje ky veprim. Letërsia shqipe është një e tërë, pavarësisht se ku botohet dhe çfarë tematike ka. Në të vërtetë, tani më ra ndër mend se para tre vitesh Ministria e Kulturës e Kosovës e hoqi librin tim nga konkurrenca për njëfarë çmimi me shpjegimin se ishte botuar në Tiranë. Mbeta i çmeritur. Nuk e kisha besuar se marrëzira të këtilla ndodhin ende. Pra, hapësira kulturore dhe letrare shqiptare është unike dhe e pamundur që të ndahet në provinca letrare. Unë bëj letërsi shqipe dhe i referohem një lexuesi të supozuar të mbarë hapësirës shqiptare. Më anë tjetër, duhet të kuptojmë edhe një gjë: libri dhe botimet janë të parët që e kanë integruar hapësirën tonë kulturore, ndërsa mua më pëlqen të jem i përfshirë në këtë integrim, pa kufizime tematike dhe, ç'është më me rëndësi, pa kufizime gjuhësore. Dhe pikërisht, sa i përket gjuhës, ndihem i barabartë me çdo shkrimtar shqiptar që shkruan në Tiranë, ose kudo gjetkë. Të shkruarit shqip në kuptimin e plotë të fjalës është themeli dhe rrafshi ekzistencial i letërsisë që përpiqem të bëj. Fundja, pse të mos e themi krejtësisht qartë dhe pa komplekse: letërsia e Kosovës nuk ekziston më, sepse kanë pushuar faktorët që e kanë kushtëzuar ekzistencën e saj. Ishte një përvojë letrare e letërsisë shqipe, siç ishte dikur, ta zëmë, letërsia arbëreshe. Tani nga letërsia e Kosovës ka mbetur vazhdimësia e një përvoje letrare, e cila gradualisht po integrohet në letërsinë e gjithëmbarshme shqipe.

Mendoj se ky libër do të të vendosë padyshim në një debat, ndoshta diskutim për një vështrim personal të Prishtinës për ashpërsinë, dashurinë, dhimbshurinë tuaj?

Besoj se ka kaluar koha, kur letërsia vendoste debate ose diskutime. Së paku te ne kjo ka kohë që nuk ndodhë më. As tani nuk do të ndodhë, sepse ne nuk kemi krijuar ambient kulturor, në të cilin do të diskutoheshin pikëpamje dhe ide që burojnë nga fusha e artit. Te ne diskutohen pikëpamjet politike, nuk diskutohet asgjë tjetër, në një kohë që aty, pra në politikë, ka një shterpësi të madhe idesh. Por edhe nëse diskutohet, gjë që pra nuk e besoj, diskursi sërish do të dominohet nga idetë politike, duke iu referuar autorit si kritik i ashpër i realitetit dhe jo si realitet që prodhon zhgënjimin. Më anë tjetër, askush nuk do ta mendojë se ndërgjegjja kritike e letërsisë qëndron mbi çdo vetëdije tjetër kritike, ndërsa duhet marrë parasysh se pyetjet ekzistenciale që shtrohen në këtë roman nuk janë filozofema të zbrazëta, por kanë një arsye, sepse nxiten nga një mori faktorësh socialë, kulturorë, politikë, historikë etj.

Pse është e pamjaftueshme liria për Kosovën, një shqetësim që e shoqeron gjithë romanin?

Të gjithë njerëzit që kanë lindur në liri, nuk kanë pse të mendojnë për lirinë dhe vlerat e saj. Ndryshe është kur jeton në dy kohë, lindë dhe rritesh në një mungesë lirie, lirinë e quan ëndërr shpesh të paarritshme, pastaj përnjëherësh ajo bëhet realitet. Tani gjendesh në situatë që duhet ta peshosh vlerën e saj. Ata që kanë lindur në liri nuk e peshojnë vlerën e lirisë. Ç'është, pra, ajo liri? Ajo krijon disa predispozita që njeriu të jetojë më mirë, por nuk zgjidh asnjë problem filozofik, ekzistencial. Të gjitha liritë janë të pamjaftueshme, por liria e Kosovës është dyfish e tillë, sepse pritja ka qenë e madhe. Pastaj, kur ëndrra bëhet realitet, ju e dini se e humb madhështinë dhe shkëlqimin e saj. Më pas vjen ana pragmatike: Kosova nuk është e lirë nga shtrëngesat e saj, nga pamundësitë e saj. Ajo tani është rob i veseve njerëzore, i vanitetit njerëzor, i djallëzisë njerëzore. Ajo nuk qeveriset mirë, njerëzit kanë humbur iluzionet dhe ëndrrat e tyre, të gjithë duan të jetojnë diku tjetër. Kjo është tragjike. Fundja është njësoj si liria juaj më 1991. Ju përnjëherësh u gjendët të lirë nga diktatura, por nuk dinit çfarë të bënit me lirinë tuaj. Tani sekush e gjeti një zgjidhje: të braktisë Shqipërinë dhe Kosovën, siç vjen një çast kur duhet të braktisësh iluzionet, ëndrrat. Kjo është e dhimbshme, por është gjendje reale.

Ju hyni në qytet, lagje, rrugica, nëpër shtëpi, ata që lidhen me qytetin, për t'i njohur, dëshmuar... Pse ka qenë domosdoshmëri kjo për romanin?

Nuk e di a ka qenë e domosdoshme, por kjo është zgjedhja ime. Unë e kam projektuar një realitet, unë jam shkrimtar, romani është imi dhe unë kam të drejtë ta bëj këtë. Por që kjo të ketë një arsye të mbështetur, më duhet t'ju them se tani letërsia nuk njeh kufizime përjashtuese dhe kode që imponojnë zgjidhje të përhershme. Pra, ashtu siç ndodh zakonisht, unë mora një Prishtinë reale, të tillë siç e njoh tani dhe siç e kam njohur dikur, e bashkova me fiksionin dhe bëra një "qytet letrar", që nuk është i lehtë për t'u përshkruar, aq më pak për të jetuar në të. Po këtë dikur e kam bërë me Tiranën, te romani "Hotel Arbëria".

Nuk mund të rrimë pa pyetur për Panairin e Librit në Tiranë: çfarë ndjesish keni kur imagjinoni lexuesin shqiptar? Sa lexojnë shqiptarët e të dy anëve.

Nuk kam ndjesi të veçantë, sepse lexuesi shqiptar nuk e shoh si turmë, shoh vetëm lexuesin individual, ai më bën përshtypje. Nëse e kam një lexues, një të vetëm, unë i falëm atij, askujt tjetër, vetëm ai më bën të ndjehem shkrimtar. Më anë tjetër, Panairi i Librit në Tiranë për mua është shumë i rëndësishëm, sepse që njëzet vjet e këndej të gjitha veprat që i kam botuar, këtu i kam paraqitur për herë të parë. Panairi i Tiranës është ngjarje kulturore, ku unë ndihem tamam shkrimtar. Me të nuk mund të krahasohet asnjë tjetër.

Botimet 'Onufri" me romanin e ri, më provokues të Ridvan Dibrës - "Dashuritë e virgjëreshës Madalenë" – rrëfimi në vetë të parë, i adoleshentes Madalenë dhe fati i pesë vajzave në tre breza ku dialogu tregon denatyralizimin e shoqërisë



RIDVAN DIBRA: SI BASHKËJETOVA ME MADALENËN

Dashuritë e virgjëreshës Madalenë…me një titull mistik, që jo të gjithë mund ta lidhin me një realitet, me jetë shqiptare, e për me tepër me një autor që vendos vetveten në rrëfimin e parë, sikur të ishte "vajzë". Si erdhi ky roman?

Po, titulli josh e provokon. Edhe pse nuk ka qenë ky synimi im. Të paktën, jo në titull. Si të lexohet romani, do shihni se titulli i veprës nuk ka domethënie mistike a biblike. Thjesht është ruajtur titulli i "burimit" të këtij romani, domethënë i monodramës së quajtur "Dashuritë e virgjëreshës Madalenë". Pra, siç e kam thënë edhe njëherë tjetër, ky roman është mbështetur mbi një monodramë timen të hershme, por me ndryshime thelbësore në strukturë e në përmbajtje. Për t'ju përgjigjur pyetjes suaj, do të thosha se ky roman erdhi si një nevojë e imja për ta "rishkruar", përpunuar e plotësuar monodramën e dikurshme, duke mos qenë krejt i kënaqur me të. Ndjesi që e provoj me çdo vepër timen.

Historia juaj lidhet, siç e thoni, me absurditetin e shoqërisë, sa e panjohur është një moshë aq delikate si adoleshenca. Pse e vutë vetveten, rrëfimin në vetën e parë, mendoj se nuk ka qenë aspak e lehtë për ju?. Rrallë shkrimtarë e bëjnë këtë të ndërtojnë "Lolitën"…A është sipas jush Madalena një Lolitë?

Po, keni të drejtë, ka jo pak absurd në vepër. Siç ka, mendoj unë, edhe shumë realizëm. Ndër tri etapat e jetës së Madalenës të përshkruara në roman, ajo e adoleshencës paraqitet më problematikja. Problematike jo vetëm për Madalenën, por dhe për krijuesin e saj, domethënë për autorin, për mua. Sa ia kam dalë ta japë "realisht" një mister të tillë si adoleshenca? Nuk e di. Do ta gjykojnë të tjerët. Kurse rrëfimi në vetën e parë kushtëzohej pikërisht nga "burimi" i romanit, domethënë nga monodrama. Natyrisht që një formë e tillë rrëfimi, kur rrëfyesi duhej të "ndërronte gjini" paraqiste jo pak vështirësi e probleme… Uroj t'ia kem dalë. A është Madalena një Lolitë? Jo, jo, Madalena është diçka tjetër, mendoj unë. Bile, herë - herë më duket si antipod i saj. Edhe pse lexuesi mund të ndërtojë analogji mes këtyre dy karaktereve, unë mendoj se Madalena është thjesht një Madalenë.

Çfarë ju ka shqetësuar më shumë në procesin e shkrimit të romanit, sa kohë ju ka marrë?

Ajo që më ka shqetësuar gjithnjë te romanet e mi: puna me gjuhën, me fjalën e frazën. Por jo pak edhe me strukturën e veprës. Kurse koha, sidomos me këtë roman, vështirë të përcaktohet. Kam filluar të mendoj për këtë vepër që para 5-6 vitesh, kur ndihesha jo krejt i kënaqur me monodramën time. Domethënë, ka 5-6 vjet që bashkëjetoj me Madalenën. Kurse procesi i shkrimit të romanit ka zgjatur mbi një vit.

Ju vendosni vetveten, shkrimtarin në sfond..si një i vëzhguar, me të cilin flirtohet..A ka ndikuar në këtë kontekst, edhe përvoja juaj si pedagog për ta diagnostikuar fenomenin?

Pa dyshim! Them se pa këtë përvojë vështirë të finalizohej ky roman.

Pesë vajza, në tre faza të jetës. Një dialog që tregon denatyrizimin e shoqërisë. Siç mund të mendojë edhe lexuesi, a është jeta, dhe fati i femrës shqiptare apo i femrës në përgjithësi?

Siç mund ta keni vënë re gjatë leximit, në roman mungojnë referenca hapësinore (kombëtare, lokale) e kohore. Me një zgjedhje të tillë ndoshta kam dashur të them se problemet e trajtuara në vepër, domethënë ato të femrës, nuk janë thjesht tonat, porse dukuri, "sëmundje" globale tashmë. Ndoshta tepër ambicioz një synim i tillë. Porse pa ambicie nuk ka krijim.

Në roman lexuesi do të ndeshet me momente provokuese, gjendje jo të zakonshme për çfarë mendojnë adoleshentet, e sidomos femra. Një fabul që duhet medoemos të shkelë nëpër shkolla si problemtikë, shqetësim dhe mendësi. Sa jeni përgatitur ta përballni librin tuaj me lexuesin, e sidomos atë adoleshent?

Po, është vepra ime më provokuese. Në rrafshin e fabulës e kam fjalën. Edhe pse, sipas mënyrës sime, kam "provokuar" dhe në romanet e mi të mëparshëm. Por provokimi me një vepër letrare nuk ka qenë e nuk është synimi im kryesor. Ai, domethënë provokimi, vlen si tërheqje vëmendjeje, si "grackë" për lexuesin i cili, më pas, duhet të përballet me të gjitha problematikat e një teksti, që unë e gjykoj serioz. Kurse përballja e librit me lexuesin, qoftë ai edhe adoleshent, veçse do më gëzonte. Mjerim për një shkrimtar do të ishte indiferenca dhe shpërfillja nga lexuesi; për lexues seriozë e kam fjalën.

Ju jeni në këto ditë të panairit, në Francë në një takim letrar, ku prezantohet në gjuhën frënge romani juaj, Legjenda e vetmisë…Pse merr rëndësi, për ju personalisht, kjo njohje?

Në fakt, do të jem aty për një takim letrar së bashku me tre kolegë shqiptarë. Kurse prezantimi i "Legjendës së vetmisë" në gjuhën frënge u bë para pak kohësh në Paris dhe unë, domethënë autori, nuk isha i pranishëm. Natyrisht që një përkthim në gjuhë të huaj, aq më tepër në frëngjisht, është fakt i bukur dhe emocionues për një shkrimtar. Dhe unë me emocione e kam përjetuar. Por jo aq sa për t'i kaluar në rend të dytë lexuesit e mi shqiptarë.

Përballja me lexuesin

Onufri me autorët më të mirë shqiptarë, bashkëkohorë

A është koha për të kontekstualizuar letërsinë shqipe të pas '90-ës, si sistem? Edhe pse po afrohemi në mbylljen e dekadës së tretë të shkëputjes nga "esteitizmi" i realizmit socialist ende nuk kemi një histori letrare me të dhëna të përpunuara mbi "letërsinë e re", ose përkundër asaj që e zhvendosi dhe denatyralizoi librin shqip nga tradita e moderniteti që u shfaq në vitet '30-'40, ku po hynte e zhvillohej letërsia shqipe. E megjithatë, me një përpjekje të guximshme, disa shkrimtarë kërkuan të identifikonin me ngulm individualitetin duke u rebeluar ndaj formës, dhunës gjuhësore, dhe mungesës së lirisë. Mendësia si shkaktarja me e errët e psikës shqiptare reflektoi jo pak ngërçe në këtë përpjekje për të dhënë frymë e shpirt përmbajtjes së re letrare. Shkrimtarët pa pengesën politike, por tani me vështirësinë për të mbijetuar, e përballën veprën e tyre edhe me lexues të ç'mësuar nga shija e leximit, dhe historia e tyre letrare, e indoktrinuar. Në këtë nxitim të vështrimit, autorët shqiptarë që ndërtuan jetën letrare së paku brenda vendit (e në raste të rralla, sidomos pas viteve 2000, që patën vlerësime sporadike jashtë vendit) gjenden sot në një situatë pothuaj mohuese, shpërfillëse. Kur sondazhet për librin, fizik, nuk shkojnë në favor të autorit, dhe për leximet kanë tronditur pothuaj "ndërgjegjen" e, tërhequr vëmendjen për krizën e tij (librit) botimet "Onufri" zgjojnë për një situatë krejt të kundët. Shkrimtarët si gjithnjë të pabindur, me instiktin "mainstream", pra shkrimtarët shqiptarë në këtë edicion të panairit të librit në Tiranë vijnë si një përgjigje. Janë gjashtë autorë bashkëkohore që shtëpia botuese Onufri hedh ekskluzivihst në qarkullim me tituj të rinj. Mira Meksi, Mehmet Kraja, Ridvan Dibra, Agron Tufa, Virion Graçi – nga të rrallat raste nga një botues – realizojnë një hartë të re letrare, qoftë në veprën e tyre, si histori, ashtu edhe në gjeografi leximi. Mira Meksi me tregimet "Hakmarrja e Kazanovës" nga kujton se si shija letrare, shkrimi, dhe gjitha bota e imagjinatës krijojnë një komunikim par excellence, plot finesë, erudicion dhe elegancë vëzhguese. Në epizimin e shkrimtarit Mehmet Kraja shtrihet moderniteti i romanit të tij të fundit "Prishtina", njëherësh dashuri, e mjaft herë greminë e pandreqshme e një qyteti me frymë të marrë. Dashuritë e virgjëreshës Madalenë-shkrimtari shkodran, Ridvan Dibra ngre kurthe të jashtëzakonshëm nga bota e adoleshencës. Një dialog i rrufeshëm në botën e panjohur femërore, e rrëfyer në vetë të parë përplas kulturën tonë të njohjes dhe refuzimit të jetës më të çmendur, plot aventura psikologjike e të vështirë të adoleshentëve. Ironia dhe konstrukti i një shkrimtari për t'i dhënë lexuesit, e sidomos këtij shqiptar, por dhe çdo tjetri, atij të huaj për ne, diktaturën në formën me njëerëzore të dhimbjes, dhimbshurisë. E rrëfyer nga ditëte sotme, si një klasik i regjur me punët e shpirtit, Virion Graçi në romanin e ri "Pëllumbat i vrasin natën" shkon sërish drejt përpjekjes së tij të vazhdueshme, edhe në romanet e mëparshme, të ç'kompleksojë figurën e Babait, mbi një raport të individit të sotëm me të shkuarën, historinë– si një gjak përtej dashurisë, si mirësi e dhimbshuri. Secili reflekton nje letërsi të çliruar me historinë e tij, të kësaj kohe. Shqetësimet dhe përballja me Njeriun sot, si dhe liria krijuese ku ndihet tensioni krijues i shkrimtarit - na kanë dhënë prurjen e munguar në këto vite, njëherësh të gjithë bashkë e njëherësh me arsye për të rindërtuar raporte të hapura, e të qëndrueshme me lexuesin.

V.M.



JETA PARALELE E DIPLOMATIT

Një libër i mirë s'ka nevojë për komente. Ai është si kroi në mal: mjafton të bësh me shenjë ku ndodhet, i eturi shkon te gurra vetë. "Një jetë në diplomaci", - vetëm një jetë? Diplomati bën jetë paralele. Punët e dukshme, përditshmëria, si për çdo zyrtar, janë njëra. Por diplomati duhet të lexojë gjëra që syri i të tjerëve nuk i sheh. Jo rrallë profesioni e do që tjetër të kesh në mendje e tjetër të thuash, tjetër të dëgjosh me veshë e tjetër të dëgjosh me mendje. E do të buzëqeshësh kur të dhemb shpirti ose e kundërta. Në këtë kuptim, ambasadori Peka mund të flasë për dy jetë. Vazhdimësia në detyrë në dy epoka aq larg njëra-tjetrës, nga diktatura në demokraci, është një përvojë e pazakontë. Po aq sa dhe misionet diplomatike "flakë e borë": nga Vietnami në zjarr, ku skenat e luftës dridhnin planetin, në Parisin vezullues, ëndërr për çdo diplomat; nga bota arabe me veçoritë e kulturës dhe ekzotikën, në një metropol aziatik si Pekini, që tronditi botën me ritmet marramendëse të zhvillimit.

Një kaleidoskop diplomatik i papërsëritshëm, me të cilin autori josh, intrigon, jo nën trysninë e emocioneve. Me të vërteta arritjesh dhe mosarritjesh. Mund të thuhet se Maxhun Peka ka pasur fat? Me gjasë, fati në këtë botë vështirë përjashtohet si faktor. Por fati ka diçka të përbashkët me talentin. Të dyve duhet t'u shërbesh fort me punë. Thonë fati duhet mbërthyer për flokësh. Si mund të mbërthehet "për flokësh" në diplomaci?

Ka një formulë të thjeshtë sa dhe të ndërlikuar, u thotë Peka pasardhësve me këto kujtime. Profesionalizmi mbi politikat e brendshme të ditës, mbi ideologjitë. Dashuria për vendin tënd, përkushtimi për të, jo për partitë e individët. Lëndë jetësore tepër e vëllimshme, si me e përmbledhë në një libër të vetëm? Në jetën profesionale të Pekës ka edhe plot ngjarje e imtësi, që bërtasin e shtyjnë me bërryla. Hapuni, edhe ne duam hapësirë në libër, kemi sharm, kemi domethënie. Duke hyrë në lëkurën e autorit, e ndiejmë që s'e ka pasur lehtë, çka me përzgjedhë më përpara? Zgjidhja më e mirë për këto "hatërmbetje", një libër i dytë.

Nuk dimë ç'ka në mendje ambasadori Peka, mendjet e diplomatëve janë të palexueshme.

Mehmet ELEZI

Pas 70 vitesh, kthehen në atdhe, eshtrat e shkrimtarit dhe veprimtarit të pavarësisë, Mid'hat Frashërit, i cili prehej në New York.

Me këtë rast, është organizuar një ceremoni shtetërore që përkonte me javën përkujtimore të 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit.

Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo" boton vellimin e tretë të veprës së plotë të Mid'hat Frashërit

"Këto gjërat e vogla që po i jap sot këndonjësit, nuk janë të ra. Shumë prej tyre janë të botuara në Kalendar kombiar dhe të tjera flinin gjysmë të harruara në mes të kartravet. Të mos ishte këshilla e disa miqve indulgjentë, pa dyshim që të gjitha do të mbeteshin të varrosura, të harruara mbase edhe prej meje vetë, si çdo gjë që e than dhe vdjer koha, si gjithë këto gjurma që i prish dhe i shuan moti.

Tani po i shtyp këtu të pandërruara, me atë kujdes që e bën njerinë të dojë ruajtjen e kujtimevet të tij, që e bën të shtrëngohet për të përsëritur ngjyrat gjysmë të shuara.

Sofje, 18/31 janar 1915"

Kjo është parathënia që hap vëllimin e tretë të krijimtarisë së lënë trashëgim nga Mid'hat Frashëri. Kthimi i eshtrave në atdhe është një ngjarje historike duke kthyer vëmendjen tek një nga personalitetet më të rëndësishëm të politikës, mendimit dhe kulturës shqiptare.

Instituti i Studimeve Historike "Lumo Skëndo" me kujdesin e përgatitjes për botim nga Dr. Uran Butka, u jep lexuesve shqiptarë mundësinë e njohjes së Mid'hat Frashërit edhe në aspektin shpirtëror.

Krijimtaria letrare e Lumo Skëndos e përfshirë në këtë vëllim, përmban prozën poetike të botimit "Hi dhe shpuzë" të vitit 1915 në Sofje, si edhe tregimet, skicat dhe rrëfimet poetike të tij, që ruhen në dorëshkrim në Arkivin e Shtetit, të pabotuara më parë, si "Të përënduarit e diellit", "Qyqeja", "Kroi", "Eja mike", "Sytë", "Bariu", "Moli i vogël", "Në kishë", "Kovaçi", "Sizifi" e të tjera, mbi 60 proza të shkurtëra poetike e meditative, të panjohura për lexuesit dhe studiuesit. Në këtë botim zë vend edhe drama e vetme e autorit "Foleja Kombëtare", me katër akte, që trajton çeljen e shkollës së parë shqipe të vajzave në Korçë më 23 tetor 1891.

Po ashtu, në këtë vëllim ngërthehen edhe analizat (kritikat) historike, kulturore dhe politike, që autori i ka shpalosur te rubrikat "Duke kënduar një libër" dhe bibliografitë, botuar kryesisht tek revistat "Diturija" dhe "Hylli i Dritës".

Një vend të veçantë zënë fjalët e urta të krijuara nga autori dhe meditimet e thukta, të nxjerra nga veprat e tij. Kështu që gama e krijimtarisë si tregimtar dhe një nga themeluesit e prozës së shkurtër moderne shqiptare, edhe si dramaturg, mendimtar, analist, kritik, bibliograf etj, zgjerohet për lexuesit e studiuesit dhe bëhet më e plotë e më e larmishme.



Një ekspeditë historianësh të lashtësisë përndjekin misterin më të madh të jetës së Kazanovës, princit venecian të joshjes dhe njërit nga shkrimtarët më të mëdhenj të Rilindjes europiane. Zbulimi i tij trondit jo vetëm biografët e Kazanovës, por mbarë njerëzimin. Një tragjedi e padëgjuar pason... Kujtimi i ardhur befas nga fëmijëria zbulon një dashuri të pathënë dhe një krim të vjetër pasioni.
E fshehta e dashurisë së përjetshme ndodhet në Malin e shpirtrave në një qytet legjendash në Spanjë. Deri ku shkon lidhja që krijohet mes shkrimtarit të madh dhe lexuesit të tij? Mikja e zemrës kthehet nga vdekja për të shprehur një mirënjohje vrastare. Në ujërat e pasqyrave të moçme veneciane me cipë mërkuri vallëzohet flamenko me taka metalike. Mira Meksi vazhdon ta mbajë të mbërthyer lexuesin në magjinë e novelave dhe tregimeve të saj në librin e ri "Hakmarrja e Kazanovës".

MIRA MEKSI: JEMI INDIVIDË TË PËRGJUAR NGA SHOQËRIA KUDO

Pas përmbledhjes me novela dhe tregime "Flutura mes gjinjve" të botuar një vit më parë, pas botimit të dy novelave përpara dy vjetësh, Mira Meksi po i sjell sërish lexuesit një përmbledhje të re me një novelë të gjatë dhe pesëmbëdhjetë tregime, me titullin grishës "Hakmarrja e Kazanovës". Lexuesi ju njeh si shkrimtare romanesh, tanimë i jeni kthyer tregimit?
Në të vërtetë pasioni im i parë ka qenë për tregimin, madje për tregimin e shkurtër. Që në filim të viteve 90 kam botuar dy përmbledhje me tregime, përpara se t'i futesha romanit. Është e vërtetë që janë tre vite radhazi që po i sjell lexuesit këtë gjini të letërsisë. Mendoj që hë për hë " i kam larë llogaritë" me tregimin dhe lexuesi im për një kohë relativisht të gjatë, mendoj, do të ketë sërish vetëm romane prej meje.
Pas botimit të romanit historik dhe shumë impenjativ "Mallkimi i priftëresha të Ilirisë" vijnë tregimet, çfarë raporti krijohet mes tyre, si ndiqet ky proces?
Ndonëse më pëlqen më tepër tregimi i shkurtër si gjini, ndihem shumë më mirë duke shkruar romane, për hir të lëndës së bollshme dhe kohës së gjatë. Sigurisht romani është një gjini shumë komplekse, por edhe komode. Për t'iu futur shkrimit të tij mjafton të njohësh fillimin dhe fundit, gjithçka tjetër lind më pas dhe zhvillohet natyrshëm. Duhet vërtet strukturuar siç duhet, por edhe ndonjë gabim në këtë kuptim, ka mundësi të korrigjohet gjatë rrugës së tij të gjatë. Ndërsa tregimi është shumë i vështirë për t'u shkruar, gjithçka tek ai duhet të jetë e përcaktuarr që në nisje. Aty operohet me një lëndë të brishtë dhe shumë të çmuar që ftohet shpejt dhe që duhet punuar për t'i dhënë formë me shumë shpejtësi dhe saktësi milimetrike.
Do doja të ndalesha te novela që i ka dhënë edhe titullin kësaj përmbledhjeje, "Hakmarrja e Kazanovës". Ju nuk po i ndaheni Venecias dhe noveles policeske nga sa po konstatoj. Si shkuat gjer te Kazanova? Cfarë ju tërhoqi apo ju frymëzoi tek ai? A mund ta quaj këtë novelë një novelë dashurie, misteri, dhe njëkohshëm policeske?
Po Venecia, sidomos ajo e fshehta, e mistershmja, Venecia e errët, e legjendave dhe miteve, por edhe e krimeve të bujshme më tërheq shumë, sepse ngaherë, gjatë vizitave të mia, zbuloj gjëra të cilat mëpastaj ushqejnë shkrimësinë time. E cilin shkrimtar nuk do tërhiqte Kazanova, "Joshësi venecian" më i madh i të gjitha kohërave? Por Kazanova ka qenë edhe një nga shkrimtarët më emblematikë të Rilindjes europiane, vepra që ka lënë, sidomos "Kujtimet" e tij janë konsideruar si një enciklopedi e shoqërisë, politikës, oborreve mbretërore, etikës, zakoneve të epokës së tij. Novela hedh dritë në këtë pjesë pak ose të keqnjohur të jetës së tij. Ka nota të theksuara të novelës policeske, ka shumë mister, ka shumë ezoterizëm, magji, shumë dashuri, por ama shpirti policesk i saj jepet në mënyrë shumë specifike, nga gjurmimet e një ekspedite historianësh, studiuesish.
Si përherë në shkrimësinë tuaj ka shumë erudicion, shumë të dhëna dhe njohuri për lexuesin. Duket sikur strumbullari i ngjarjeve te "Hakmarrja e Kazanovës" është gjurmimi prej ekspeditës së historianëve i "Manualit të dashurisë" që, me gjasë, ka shkruar Kazanova, por që nuk është zbuluar kurrë. A ka ekzistuar vërtet një Manual i tillë? Cila është zanafilla e tij tek ju si shkrimtare?
Mendoj se të gjithë ata që njohin sadopak jetën tejet të ngjyrshme aventurore dhe "bëmat" dashurore të Kazanovës, magjinë e tij si ngashnjyes apo princ i joshjes, kanë kërkuar të dinë ca më tepër, sidomos të njohin " sekretin" që e bën Kazanovën

të parezistueshëm ndaj grave. E pra, të gjithë do të kishin interes të gjenin dhe të lexonin një Manual apo një libër me rregulla apo metoda të joshjes, të shkruar nga vetë dora e tij. Dhe kërkimi i këtij manuali plot të fshehta në këtë novelë çon në të tjera mistere dhe të fshehta që janë shumë më interesante se një manual i tillë, gjer në kufijtë e pabesueshëm të legjendës dhe tragjedisë...
Porse duket se thelbi i kësaj novele që porsa i ka ardhur në dorë lexuesit, jepet që në krye të tij, me anë të një fragmenti të shkëputur nga libri *Identiteti* i Milan Kunderës.
Po, thelbi i kësaj novele është dhunimi identitetit të njeriut. Në shoqërinë e sotme, ashtu siç shkruan edhe Kundera, individi përgjohet nga shoqëria në gjithçka, kurdo dhe kudo, që në bark në nënës dhe gjer pas vdekjes, edhe me shekuj pas vdekjes, siç ndodh edhe me Kazanovën në këtë novelë.

BIOGRAFIA

MIRA MEKSI është shkrimtare dhe përkthyese shqiptare. Meksi është nderuar me mjaft çmime prestigjioze shqiptare dhe të huaja, ku vlen per tu përmendur çmimi "Përkthimi më i mirë i vitit 2006 "me romanin "Kujtim Kurvash të Trishta" nga Gabriel Garcia Marques dhënë nga Ministria e Kulturës. Vepra e shkrimtares Mira Meksi, është përkthyer në disa gjuhë të huaja si dhe është botuar nga disa shtëpi të huaja prestigjoze, ku përmendim botimin e Romanit "E Kuqja e Demave", i cili është rishkruar nga vetë autorja në frëngjisht dhe është botuar në Paris, nga shtëpia Botuese "Persee".

VIRION GRAÇI: KAM DËSHMUAR PËRJETIMET E MIA

***Pëllumbat i vrasin natën*... një titull alegorik për të zbuluar historinë apo disa histori? Çfarë ju nxiti të shkruanit këtë roman?**

Më tepër ky titull është mendim, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës. Pëllumbat, këta shpendë të bukur që zbukurojnë sheshet e parqet publike në vendet e qytetëruara, por edhe banesat private, pullaze e ballkone, bëhen sinonim i vetë fatit tonë, i dëshirave dhe ëndërrave tona të bukura të cilat shpesh, në errësirën e një ekzistence kolektive zhytur në errësirën e poshtërsive, intrigave, shthuren natën, sakrifikohen, përgënjeshtrohen pa mëshirë. Besoj se romani zbulon mjaft histori, histori fatesh specifike njerëzore, pra, sjell në jetë personazhe artistikë sikurse, shpresoj t'ia kem dalë mbanë, flet hapur e qartë edhe për epoka të rëndësishme nëpër të cilat është tezarur si në zgrip humnere jeta jonë si shqiptarë. Nxitja për ta shkruar? Ç'do roman flet për mungesën e lumturisë, ka shkruar dikur një romancier i madh..

Përse keni nisur këtë roman jo autobiografik me një epigraf kushtuar djalit tuaj?

Si autor i këtij romani i shërbej si ciceron kohës sonë kohëve që do të vijnë duke dëshmuar përjetimet e mia, mendimet e mia, bilancet e mia intelektuale-shpirtërore për realitete komplekse historike të cilat harresa, xhurma, propaganda, zhdukja e provave materialeve – fizike si dhe shkujdesja mund t'i fshinë duke i lënë teren miteve të rreme, herojve të rremë; nga ana tjetër mund të mbulohen e të harrohen padrejtësisht njerëz e modele që duhet të meritojnë vëmendje, dashuri, amëshim Fakti se ia nis tim biri këtë lloj rrëfimi artistik është premtimi im për sinqeritet, për ndershmëri.

Na tërheq që në hyrje shënimi që ky roman të lexohet si një fikison dhe përkimet me ngjarje a persona konkretë janë të rastit., ndonëse të pashmangshme? Përse kjo vrejtje?

Të tilla shënime janë taksativë në botën e librit fikshën, ne ende nuk kujtohemi të përdorim nga këto siguresa të zakonshme kundër keqkuptimeve të lexuesëve a kundër keqinterpretimeve të qëllimshme të spekultantëve mediatikë.

Në qendër të romanit janë dy vëllezër jeta e të cilëve vjen nga anë të ndryshme të historisë. Cili është sipas jush raporti midis njeriut si individ dhe historisë? Po raporti i të vërtetave vetjake me historinë e përgjithëshme të shoqërisë?

Pyetja juaj do të donte si përgjigje një punim monografik në filozofi. Meqë romani im, si çdo krijesë artistike e bën subjektin njerëzor masë, gur prove e metër matës të botës së madhe, mund të shohim te personazhet e mi të përmendur prej jush edhe tipa të përvetshëm por edhe mishërime fragmentare të epokave nëpër të cilat ata janë mbrujtur, kristalizuar, afirmuar e transformuar.

Në pjesën e tretë të librit ju tregoni për fëmijë-burra të cilët vihen në kërkim të etërve të humbur. Cila është domethënia e kësaj gjetjeje në mendimin tuaj e në funksion të historisë romanore?

Ashtu duket në plan të parë, në lexim të përgjithshëm; mua më pëlqen të përjetohet/lexohet/interpretohet kjo pjesë si epilogu i stërgjatë i zhgënjimeve të cdo brezi që vjen në skenën e historisë duke dashur të ndreqë a të zhbëjë gabimet kapitale të brezave pararendës; në këtë ambicie brezat debutues bëjnë disa mëkate themelore, mëkati i krenarisë ribërëse është i pari ndër ta, por jo më i qortueshmi.

Një personazh krejt i veçantë është nëna, Neta, dikur vajzë shumë e bukur, guximtare në dashuri e fatkeqe, tragjike në jetë aq sa, e moshuar ka humbur kujtesën. Është kjo figura kyçe e romanit? Është një heroinë e pranishme e vizatuar nëpërmjet mungesës së saj?

Po, Neta është figura kyçe e romanit: në planin e parë, si roman me histori dashurie mes dy të rinjeve, çka është vërtetë romani, ajo është vajza që dashuroi me sinqeritet, me guxim, flijueshëm; në planin simbolik, kur në moshë të thyer ka humbr kujtesën ajo nuk është më vetëm njeri, vetëm personazh por shndërrohet në simbol, në shenjë përfaqësuese për gjendjen tonë në udhëkryqet e kohëve të reja.

Përsëritet shpesh shqetësimi për mungesën e lexuesve. Jeni dhe ju i këtij mendimi? Ka vend për letërsi të mirë? Për letërsi shqipe?

Lexuesi ynë nuk e ka tradhëtuar librin, as librin e mirë shqiptar; ritmet e leximeve mund të njohin ulje-ngritje por libri do të jetë te ne ashtu si ka qenë: një formun i shenjtë ku bashkëjeton vlera estetike me vlera të tjera etike-morale e humane. Bilancet, anketat janë përditshmëri, libri i mirë nuk mplaket edhe kur është i detyruar të presë lexuesit më gjatë se zakonisht.

Me një ironi sarkastike në këtë roman tregohet fati i ndryshëm i dy vëllezërve dhe i nënës së tyre që ka humbur kujtesën. Me neutralitet gati gazetaresk ndaj fakteve, autori tregon si fijet tragjike të fatit njerëzor mund të mpleksen e të ndërvaren prej ngjarjesh kontinentale e ndarjesh botërore gjeo-politike si dhe nga shtysa të brendëshme, instinktive e patologjike të njerëzve të rëndomtë tjetërsuar prej pushtetit pa caqe, dehumanizuar deri në barbari.

Autori ndërton raportet midis individit dhe historisë ku të vërtetat vetjake me të vërtetat historike, të përgjithshme

Jeta e romanit është pas viteve 2000 ku personazhet rrëfejnë diktaturën, të shkuarën e jetës së tyre përmes të cilëve Graçi na shfaq një kërshëri pothuaj të pangopur, e të provokuar mbi ndjenjat, çfarë përjetimesh mbartin bashkëkohësit e tij.

Në këtë kontekst duke parë më dyshim ndryshimet politike të bëra më '90-ën, me ndërrimin e sistemeve, Graçi shkon në një diagnozë të dhimbshme për fatin e individit: si njeriu nuk ndërton dot në këtë vend një guidë vetjake, prespektivë të detajuar individuale.

2018, shpallur viti i Skënderbeut, ka shënuar kulmin me ribotimin e librit të Aurel Plasarit, "Skënderbeu, një histori politike", botimet IDK, vlerësuar me Çmimin Shkencor Ndërkombëtar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për studimet më të suksesshme për Gjergj Kastriotin – Skënderbeun në Vitin Mbarëkombëtar kushtuar figurës dhe epokës së tij.

SKËNDERBEU
NJË HISTORI POLITIKE

Nga AUREL PLASARI

Ky punim nuk është një tjetër jetëshkrim i Skënderbeut simbas modelit "jeta dhe vepra"; është një përpjekje për të hartuar një histori politike të "poetit të madh të politikës shqiptare", sikurse Montanelli e thirri. Kur e përmendte Skënderbeun në veprën e tij klasike Edukimi britanik ose burimi i çrregullimeve në Britaninë e Madhe Thomas Sheridani (1719-1788) e rendiste Gjergj Kastriotin ndër njerëzit e mëdhenj që do të jetojnë përgjithmonë në "tempullin e kujtesës". Nga Barleti (Barletius) deri te Sheridani, që shkruante ashtu, koha e kishte vërtetuar këtë; tanimë e ka vërtetuar edhe nga Sheridani në ditët tona. Në të mirë a në të keq, prej shek. XV deri sot e gjithë ditën, çdo brez arbërish/shqiptarësh ka parë te vepra e Gjergj Kastriotit një bashkëkohës me të cilin i duhet t'i bëjë "llogaritë": ta dashurojë ose ta urrejë, ta ndjekë ose ta mohojë, por gjithsesi ta mbajë parasysh. Noli, që u mor me të gjatë thuajse tërë jetës, pohoi aty nga fundi i saj: "Ngandonjëherë pyes veten nëse mund të ketë sot ndonjë njeri që të jetë po aq i gjallë sa Skënderbeu?" I njohur më së shumti si "Skënderbe", Gjergj Kastrioti është imponuar tanimë në historinë e Shqipërisë si figurë "heroi kombëtar", madje si "simbol" i identitetit të shqiptarëve arbër dhe i qëndresës dhe/ ose i luftërave të tyre, në nivelin e informacionit enciklopedik botëror. Si i tillë është vlerësuar ai veçanërisht prej një filoni të historiografisë europiane që e zë fillin te tradita humanisto-iluministe. Merret vesh vetiu që figura si e tija, në historinë e çdo kombi, vuajnë jo vetëm rrezikun e ngatërrimit të kufijve mes historisë dhe legjendës, por edhe të shpjegimit të njëanshëm të tyre: jashtë kontekstit të kohës ose pa lidhje me idetë e zhvilluara a me lëvizjet e organizuara përbrenda të cilave ata vetë kanë jetuar, vepruar, luftuar. Është edhe kjo një arsye që "historia e Skënderbeut" vijon të shtrojë pyetje para specialistëve shumëfarësh, dhe për të cilën ajo lypset rishkruar.



Prej kohës së Marin Barletit, kohë portretistësh të "burrave të mëdhenj" e të "princërve idealë", panegjiristët e Skënderbeut, nga njëra anë, dhe detraktuesit e tij, nga tjetra, kanë ardhur duke u ndarë dy palësh. Të dyja kanë pasur për tregues të përbashkët ngulmimin e paepur në "bindjet" e veta. Për lexuesin tonë ato kanë ndryshuar në rrafshin e njohjes: panegjiristët janë receptuar gjithnjë më fort se detraktuesit, që me gjasë e zënë fillin te Kujtesa e Muzakës, i cili nuk mundte as ta pranonte, jo më ta lavdëronte politikën e Gjergj Kastriotit për t'i shndërruar fiset arbërore në shtet. Edhe kjo situatë tendosjeje dy palësh e bën të dobishme marrjen dhe rimarrjen e "historisë së Skënderbeut": jo vetëm duke rishikuar sa për të është shkruar, por duke verifikuar tezat dhe kundërtezat në ballafaqim me burimet, enkas për sa i përket anës politike të saj. Për një këso historie politike punime monografike si Arbëria dhe pushtimi turk në shek. XV i Athanas Gegajt (Louvain 1937), Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468 i Fan S. Nolit (New York 1947), studimet skënderbegiane të Aleks Budës, deri tek ato më të fundit, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, jeta dhe vepra 1405-1468 e Kristo Frashërit (Tiranë 2002), Skënderbeu (Tiranë 2005) dhe Për Skënderbeun (Tiranë 2005) të Kasem Biçokut, jo që nuk bëhen pengesa, por shërbejnë si ndihma me mjaft vlerë.

Nëse historia në përgjithësi lypset rishkruar kohë më kohë, kjo nuk ndodh thjesht e vetëm prej zbulimit të "të dhënave" të reja. Kultura e një kombi ndryshon. Bashkë me të, konceptet zotëruese në kulturë ndryshojnë edhe ato. çdo epokë i përgjigjet ndryshe këtij problemi".

(Pjesë nga hyrja e librit)

SHQIPËRIA NË ART

Prof. Dr. Ferid Hudhri

Shqipëria në Art, paraqitet si një enciklopedi e kujtesës figurative për historinë, kulturën dhe trashëgiminë kombëtare. Përmes statujave, mozaikëve, afreskeve, pikturave, gravurave, litografive, grafikave, akuareleve, të krijuara nga kohët më të hershme deri në ditët tona, njihemi me aspekte nga më të ndryshmet të jetës në trojet e banuara prej shqiptarëve.

Krahas përshkrimit të historisë së lëvizjeve artistike, veprat e artit në këtë libër shoqërohen edhe me të dhëna për autorë të rëndësishëm, si dhe me shënime rreth realizimit të disa prej tablove më të bukura.

Botimi është i ndarë në tri pjesë:

Në *pjesën e parë* jepet një *vështrim i shkurtër i historisë së artit shqiptar*, nga gjurmët më të hershme deri te krijimtaria e ditëve tona. Është ndarë në kapituj të veçantë, si: Arti ilir dhe ndikimet greko-romake, Diaspora e hershme, Arkitektura, Arti pasbizantin, Arti katolik, Arti islam, Arti popullor, Artistët e huaj, Arti i rilindjes dhe pavarësisë, Arti i realizmit socialist, Artistët e diasporës, Arti në Kosovë dhe treva të tjera shqiptare, Drejtimet e reja bashkëkohore.

Pjesa e dytë titullohet *Shqipëria nëpërmjet artistëve të huaj*. Këtu janë përmbledhur mbi 180 piktura me temë shqiptare prej autorëve nga disa vende të botës. Shumë nga ato vepra botohen për herë të parë dhe janë rezultat i kërkimeve shumëvjeçare të autorit nëpër galeri, muze, arkiva dhe koleksione të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Tema shqiptare është pasqyruar në krijimtarinë e disa prej artistëve më të shquar botërorë, si: P. Veronese, C. Corot, E. Delacroix, Rembrandt, V. Dyck, L. Gérôme, E. Lear, H. Domje, P. Jovanovic etj. Deri tani janë zbuluar mbi 1500 autorë të huaj që kanë trajtuar motive shqiptare.

Për *pjesën e tretë*, me titull *Shqipëria nëpërmjet artistëve shqiptarë*, janë zgjedhur mbi 100 vepra: nga artistët e periudhës së Rilindjes dhe të Pavarësisë, si: K. Idromeno, S. Xega, Marubi, A. Kushi, S. Rrota, V. Mio, A. Buza, Z. Kolombi, nga piktorë të shquar të periudhës së realizmit socialist si dhe nga disa prej autorëve të njohur të ditëve tona. Ato janë vepra që i përshtaten titullit të këtij botimi.



AGRON TUFA

Fabula rasa, “rishfaqet” shqetësimi moral e shpirtëror

Ditën e shtunë, ora 11.00, shkrimtari Agron Tufa në stendën “Onufri” për të folur mbi identiteti individual, moral e shpirtëror – shqetësim që e nxiti të shkruajë romanin “Fabula rasa”, të cilin e riboton në këtë panair libri, pa ndërhyrje në tekst. Një nga romanet shqiptare që ka bërë jetën letrare prej vitit 2004, kur u botua, dhe kërkohet me po atë kërshëri nga lexuesi, e vlerësuar nga kritika



Pse ky ribotim? Çfarë është rishikuar e ndryshuar?

A.T: Për herë të parë romani është botuar në vitin 2004 nga “Ideart”. Po atë vit u shpall romani më i mirë i vitit nga juria e Konkursit Kombëtar për Letërsinë, e cila ia dha çmimin “Penda e argjendtë”.

Ky ribotim nga shtëpia botuese “Onufri”, përveç gjërave që kanë të bëjnë me korrektimin e kujdesshëm, nuk ka ndërhyrje në tekst, pra është po ai tekst i botimit të parë. Janë shkruar shumë shkrime, ese e studime të penave të njohura të kritikës e letrave për këtë roman si Luan Topçiu, Arian Leka, Arben Prendi, etj.

Dhe në këtë distancë romani mbetet një shqetësim, mbi dualizmin e njeriut, identitetin e tij moral e shpirtëror.

A.T: Normale... nëse vepra letrare ka afat skadence, ajo do të thotë se është konceptuar si një vepër koniukturale, për nevojat e një konteksti të caktuar politiko-ideologjik apo religjioz, pra, thjesht nuk është letërsi. Është poetika e shkrimit, gjuha e stili dhe filozofia që përcjell autori përmes botëkuptimit të pesaonazheve, çështjet dilematike që shtron, etj, etj. Ky roman madje, u përkthye në frëngjisht nga Etmond Tupja dhe Anë-Mari Otesje. Fragmente të tij janë botuar që më 2008 në antologji e 10 autorëve me letërsi të zgjedhur nga gjithë bota. Parathënien e tij e shkroi Atanasi dë Trasi, poet, anëtar i Akademisë Franceze dhe i është paraqitur për botim një shtëpie botuese franceze.

Debati mbi leximin, që tronditi opinionin, pse nuk lexojnë shqiptarët, a ndani të njëjtin mendim?

A.T: Është një ekuacion me shumë të panjohura çështja e leximit. Unë nuk mund të them se në Shqipëri nuk lexohet. Po, ka vend të thuhet ajo çfarë po ndodh: si gjithkund, edhe në Shqipëri po ndodh diferencimi i thellë i sferës së leximit. Më saktë, sfera e leximit po elitarizohet. Ata që kërkojnë nga kultura një marrëdhënie më të cekët e më sipërfaqësore, e gjejnë kënaqësinë në ndonjërën prej parajsave zbavitëse teknologjiko-informative, në lojëra audio-vizuale, në zbavitjet që ofrojnë ekranet e sheshta. Leximi kërkon nofulla të forta intelektuale, kredhje serioze të shkallë-shkallshme meditative në tekst, që të mund të shijosh gjuhën e stilin, imazhet dhe idetë, filozofinë dhe trillet lojacake, shijim estetik dhe filozofik. Sa është “takati” i lexuesit të gjerë për këtë “sondë” vertikale të mendimit dhe shijimit? Prandaj mund të themi, se vërtet letërsia ka humbur nga numri i madh i lexusve të saj, por nga ana tjetër ka fituar besnikët e saj të përjetshëm e të domosdoshëm. Nga leximi i lëtërsisë janë larguar “dezertorët”, të cilët nuk kanë pasë ndonjë lidhje të fortë me të, por që as nuk i bënin letërsisë ndonjë nder të madh...

Dualizimi i njeriut, përpjekja e tij për ta mbytur realitetin duke kërkuar shpëtim në lexim, në libra, në një botë të cilën ai përpiqet ta ndërtojë brenda asaj që jeton, është përpjekje e stërmundimshe e njeriut për të shpëtuar nga hiçi, nga krimbi që rritet brenda shpirtit të tij e që e përcakton deri në skaj prejardhjen prej krimbaçëve të mëdhenj. Bashkudhëtar i fatit të Martinit është Edipi. Veprimi që zgjedh Edipi për të shpëtuar fatin e tij të mëtejshëm është vetëm një vazhdimësi e formës së përdhunshme të pararendësve me të cilët ai mendonte se ndahej plotësisht, e që të kujton një marrëdhënie inçesti. Një fije në të cilën personazhi kërkon të kapë fatin e vet e ta shpëtojë është Lilita. Përdorimi i emrit Lilita prej autorit të shpie në legjendën sipas të cilës Lilita është gruaja e parë e krijuar para Evës e cila u destinua si grua që sjell vetëm shkatërrim, zjarr, disfatë, mort.

“Personazhi i Agron Tufës, përmes një dueli real dhe metaforik vihet në kërkim të vetvetes drejt shpalimit të shtresimeve të identitetit moral, psikologjik, drejt profilit shpirtëror.”– ka thënë Kadare.

Azem Deliu, një autor i ri nga Kosova, boton në Tiranë me një shqetësim real, për zejen e shkrimit: një krimb i pandershëm apo shkrimtar?! Ky guxim e ka bërë të ushtrojë mendimin, se pari mbi vetveten dhe, së dyti... pas leximit të "Shënimet e krimbit Smolinski", do të nxisë dyshime edhe tek ata që janë shkrimtarë "të mëdhenj", pse çdo gjë nis nga morali, personaliteti, karakteri dhe liria...

SHËNIMET E KRIMBIT SMOLINSKI

Azem Deliu, një autor i ri nga Kosova, boton në Tiranë me një shqetësim real, për zejen e shkrimit: një krimb i pandershëm apo shkrimtar?! Ky guxim e ka bërë të ushtrojë mendimin, se pari mbi vetveten dhe, së dyti... pas leximit të "Shënimet e krimbit Smolinski", do të nxisë dyshime edhe tek ata që janë shkrimtarë "të mëdhenj", pse çdo gjë nis nga morali, personaliteti, karakteri dhe liria...

Piotr Smolinski, shkrimtar i njohur polak, ftohet në një rezidencë artistësh në Kosovë ku ndeshet me mentalitetin e pasluftës, e që në disa pika, i kujton problemet e pas rënies së komunizmit në vendin e tij. Shkrimtari biseksual me vetëbesim të pakët, na nis në një rrëfim që kapërcen nëpër krejt problemet e fëmijërisë që kanë rezultuar ndoshta, në pasiguritë e tij të sotme. Përballjet e tij me familjen, traditën, kishën, e në fund fare, me veten, e bëjnë të mbajë nofkën dëshpëruese "krimb i pandershëm".

Ndonëse një nofkë e vënë nga të tjerët, në këtë roman ajo përjetohet si diçka që buron prej vetes. Sepse, siç thotë Smolinski, "Njeriu i merr seriozisht veç ato që ia ka thënë vetes para se t'ia thonë të tjerët". Kush është shqiptari njëzetedyvjeçar, Azem Deliu nga Kosova, antiutopia debutuese e të cilit "Puthësi i paligjshëm" po i tërheq vëmendjen lexuesit evropian. A është ai një zë origjinal dhe i freskët në letërsinë shqiptare, apo vetëm një prodhim i kritikës vendase dhe të huaj, e cila me cdo kusht do të donte ta pagëzonte si "Ismail Kadarenë e ri", shkrimtarin më të njohur shqiptar, kandidat për Çmimin Nobel?

"Deliu pikëton robërimin. Ia vlen që emri Azem Deliu të mbahet mend. Ky shqiptar njëzetedyvjeçar flet edhe për ne. Dhe na flet ne.", shkruan Dorota Horodyska, përkthyesja e shqipes në gjuhën polake. Ndërsa studiuesi dhe kritiku nga Kosova, Agron Gashi veçon se

"Azem Deliu është prozator i pasionuar pas gjuhës së dëftimit, një alkimist i fjalës deri në perfeksionizëm".

Azem Deliu u lind me 10 janar 1996 në Skënderaj, Kosovë. Në letërsi debutoi me vëllimin poetik "Funerali i shiut" në vitin 2013 ndërkohë që, si student i parakohshëm, kishte marrë çmimin "Student i dalluar". Megjithatë, suksesin që do ta bënte emër të letërsisë shqipe, e arriti me romanin "Puthësi i paligjshëm", i cili u botua edhe në Londër në gjuhën angleze dhe u lexua në Festivalin e Fabulës në Poznan të Polonisë në shqip dhe polonisht.

Pjesë të krijimtarisë së tij janë prezentuar dhe botuar në anglisht, serbisht, gjermanisht dhe polonisht. Shtypi shqiptar dhe i huaj e ka krahasuar me emra si Dostojevski, Kadare e të tjerë. "Shkrimtari i madh i vendit të vogël", titullohet komenti për të në shtypin freng ndërkohë që në gazetën më të madhe polake, Ëyborcza, u argumentua se a janë të drejta krahasimet që shtypi ia bën Deliut me Kadrenë, derisa u komentua si "një emër për t'u mbajtur në mend" pak para takimit me publikun në Rezidencën e Artistëve në Poznan të Polonisë.

Që nga mosha 19 vjeçare, Azem Deliu është antar i Shoqatës së Filozofëve të Kosovës.



















MINERVA

Rr. "Konferenca e Pezës", Nr. 71, Kodi Postar 1027, Tiranë; Tel: 00355 42 487 007; 2270 399
info@minervabotime.com | www. minervabotime.com

Minerva Botime minervabotime minervabotime.com